



01Nr. 1721
Me datë. 23. 05. 2018
Rahovec

Në pajtim me pikën 7.1 nënpika 3 të Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare (2017-2021) prill 2017 dhe pikën 4.1, 4.2 dhe 4.3 të Mekanizmit Koordinues për Zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare (2017-2021) shtator 2017, të Qeverisë së Republikës së Kosovës – Zyra për Qeverisje të mirë, Kryetari i Komunës shpall:

K O N K U R S

Për pranim të anëtarëve nga OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare në Komitetin Komunal Veprues

Numri i anëtarëve të Komitetit komunal veprues (KKV) të kërkuar :

- Nga OJQ të komunës – 2 (dy) anëtarë
- Nga OJQ ndërkombëtare – 2 (dy) anëtarë

Detyrat dhe përgjegjësitë e KKV:

- Në bashkëpunim me OJQ-të përkatësisht shoqërinë civile dhe autoritetet e komunës të inicoj hartimin e planit komunal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare (2017-2021),
- Të inicoj miratimin e politikave tjera lokale që kontribuojnë në zbatimin e objektivave të parapara në kuadër të planit komunal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare (2017-2021),
- Të koordinoj aktivitetet brenda komunës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare (2017-2021),
- Monitorimin e fondeve të ndara nga buxheti i komunës në raport me burimet e nevojshme financiare për zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në dokumentin e planit të veprimit,
- Në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të mirë, të ndërtoj instrumentet/format e mbledhjes së të dhënave dhe raportimit mbi zbatimin e strategjisë,
- Të mbledhë dhe analizoj të dhënat e drejtorive komunale për masat e ndërmarra në kuadër të strategjisë,
- Të raportoj tek Zyra e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të mirë në baza 6 mujore dhe vjetore për të arriturat në zbatimin e strategjisë,
- Të dërgoj tek Zyra e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të mirë procesverbalet e takimeve të KKV-ve,
- Të propozoj masa shtesë para drejtorive komunale me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga strategjia,

- Të propozoj tek partnerët ndërkombëtarë aktivitete të planit të veprimit të cilat nuk mbulohen nga buxheti i komunës e që mund të jenë në sferën e interesit të tyre dhe që kërkojnë mbështetjen e tyre financiare,
- Të shërbej si një platformë për shkëmbim të informatave ndërmjet drejtorive komunale , zyra, organizatave ndërkombëtare dhe organizatave tjera jo qeveritare,
- Të shfrytëzoj takimet e rregullta si një forum për shkëmbimin e rezultateve mësimore të nxjerra dhe praktikave më të mira,
- Në-vitin e fundit të zbatimit të planit komunal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare (2017-2021) duhet të bëj vlerësimin e përmbushjes së objektivave të parapara me planin e veprimit.

Kushtet:

- OJQ lokale dhe ndërkombëtare, duhet të kenë zhvilluar aktivitetin e tyre në programe që kanë për qëllim avancimin e pozitës së pjesëtarëve të komunitetit Rom dhe Ashkali,
- OJQ duhet të jetë aktive në komunë për të paktën tre vitet e fundit,
- Të jetë organizatë kredibile dhe profesionale,
- Të ketë performancë të kënaqshme për sa i përket avancimit të rolit të komunitetit Rom dhe Ashkali në integrimin e tyre në shoqëri.

Mandati:

Mandati i anëtarëve të Komitetit Komunal Veprues është i njëjtë me kohëzgjatjen e zbatimit të Strategjisë 2017-2021.

Përzgjedhja e përfaqësuesve të OJQ-ve do të bëhet nga komisioni prej tre anëtarësh i themeluar nga Kryetari i Komunës.

Konkursi mbetet i hapur 15 dite nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Dokumentet e kërkuara:

Dëshminë për regjistrim të organizatës (OJQ-së) dhe akteve tjera valide për themelimin të OJQ-së si dhe dëshminë për autorizim nga OJQ-ja, të përfaqësuesit të tyre për të aplikuar në konkurs për përzgjedhje në Komitetin Komunal Veprues.

Kërkesa për aplikim me dokumentet e kërkuara mund të dorëzohen çdo ditë pune prej orës 08:00 deri në orën 16:00 në Zyren e Pranimi të Komunes së Rahovecit.

